



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:277729

Datë: 27.06.2022

Numri i dokumentit: 03174652

A.nr.435/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçi dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit NNT “S.C.” sh.p.k. me seli në S. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. D., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, për shkak të anulimit të vendimit 01-Nr.01-016-10043 të datës 06.02.2019 dhe kërkesës për kompensimin e dëmit material, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 27.06.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit NNT “S. C.” sh.p.k. me seli në S., ANULOHET vendimi Nr.01-016-10043 i datës 06.02.2019 i të paditurës Komunës së Suharekës dhe DETYROHET e paditura që paditësit në emër të dëmit material të shkaktuar me ekzekutimin e vendimit të kontestuar, t’ia paguaj shumën prej 1,501,403.57€ [një milion e pesëqind e një mijë e katërqind e tre euro e pesëdhjetë e shtatë cent], në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material në shumën prej 2,022,969.58€ [dy milion e njëzetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë e tetë cent].

III. Ky Aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me praninë e të dy palëve ndërgjyqëse si dhe me praninë e ekspertës financiare si dhe ekspertit nga lëmia e gjeodezisë.

Paditësi me padinë e datës 19.02.2019, fillimisht thekson se me datë 03.09.2013 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në bazë të kërkesës së paditësit, e kishte pajisur këtë të fundit me licensë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror, ndërkaq licensa mbante numrin 1308/KPMM/2013 e në bazë të së cilës paditësi ishte autorizuar të shfrytëzoj gurin gëlqeror brenda zonës e cila përfshinte një sipërfaqe të përgjithshme prej 7183.60 m² e cila sipërfaqe ishte përcaktuar saktësisht dhe me koordinata të cilat ishin të caktuara nga ana e KPMM-së, e kohëzgjatja e kësaj license ishte deri më 30.08.2020 e ku kriter ligjor ishte që vendi ku do të eksploatohej guri të ishte 500 metra larg shtëpive të banimit, fakt ky të cilin e kishte vërtetuar KPMM me rastin e lëshimit të licensës për paditësin.

Pas kërkesës së disa prej banorëve të fshatit Dobërdolan për rishikimin e licencës, me datë 21.11.2013, pas shqyrtimit të së njëjtës, bordi i KPMM-së kishte konstatuar se kërkesa e banorëve të fshatit ishte e pabazuar dhe se distanca e kërkuar prej 500 metrash ishte respektuar dhe kjo vërtetohej edhe me skicat dhe matjet që i ishin bashkëngjitur licencës. Tutje, e paditura me vendimin 01-Nr.16-902 të datës 11.02.2014 e kishte shfuqizuar pëlqimin e dhënë për paditësin me arsyetimin se largësia nga vendi ku është lejuar vendosja e gurëthyesit me objektet e banimit është në largësi prej 437.2 metër. Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë nën shenjën A.nr.316/14, ky vendim i të paditurës ishte anuluar dhe çështja juridike ishte kthyer në rigjykim, ku i njëjti Aktgjykim ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit nën shenjën AA.nr.84/2018.

Pas kësaj, e paditura kishte marrë përsëri vendimin e ri të kontestuar me këtë padi, vendim ky duke përdorur arsyetime identike sikurse herën e parë duke shpërfilluar aktgjykimet e gjykatave kompetente. Paditësi pretendon se akti i goditur me padi është nxjerrë nga organi jo-kompetent mbi bazën e nenit 56 të Ligjit 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, i ndryshuar me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale. Poashtu pohon se e paditura nuk ka përfillur aspak vërejtjet e Gjykatës dhe se i propozon Gjykatës që të anuloj vendimin e kundërshtuar me padi duke vendosur edhe vet për kompenzimin e dëmit mbi bazën e nenit 46 të LKA-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit, deklaroi: *“Mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Kemi pranuar dy ekspertizat financiare dhe atë të gjeodezisë të punuara nga dy kërptët e caktuar nga gjykata. Nuk kemi vërejtje e as pyetje për ekspertet në fjalë dhe për punën në ekspertiza. Në këtë fazë të procedurës pas pranimin të ekspertizës financiare precizojmë kërkesëpadinë ashtu që kërkojmë nga gjykata të aprovoi padinë dhe kërkesën e saj dhe është konstatuar se dëmi i shkaktuar nga akti administrativ i të paditurës është në shumë prej 3,524,373.15 €. Gjykatës dhe palës së paditur në cilësi të provës material i dorëzoj deklaratën noteriale e dt. 03.07.2013, e personave të cilët kanë parcela përreth”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Pranë padisë dhe kërkesëpadisë, precizimit dhe të gjitha deklarimeve të deritanishme. Pas administrimit të provave dhe leximit të ekspertizave shohim se e paditura ka nxjerr akt administrativ të kundërligjshëm pasi që e njëjta e ka shfuqizuar pëlqimi e dhënë paraprakisht nga vet e paditura. E paditura me aktin ameditrativ të paligjshëm ka pamundësuar punën në bazë të licencës së lëshuar nga KPMM dhe përmes ati akti i ka shkaktuar dëm material paditësit andaj kërkoj nga gjykata të merr aktgjykim dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, të anulohet vendimi dt.06.02.2019 me numër 01-nr.01-016-10043, dhe të detyrohet e paditura Komuna e Suharekës që paditësit t’ia paguaj shumën prej 3,524,373.15 €, në emër të dëmit material të shkaktuar me rastin e nxjerrjes së aktit të kundërligjshëm në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm”.*

E paditura me përgjigjen në padi të datës 07.03.2022 ka propozuar që Gjykata të marr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar i marrë nga e paditura. Shton se paditësi e konteston vendimin e marrë nga e paditura dhe i qan hallin gjykatës që do të merret me shqyrtimin e këtij rasti. Pohon se e drejta procedurale ligjore për lëshimin e pëlqimit i përket komunës dhe se vet pala paditëse ka bërë kërkesë për tu pajisur me pëlqim dhe tani në padi vet pala konteston kompetencën për të shfuqizuar pëlqimin nga e paditura. Tutje, konsideron se KPMM-ja ose ka rënë në lajthim këtu të palës paditëse ose nuk ka vepruar konform kushteve ligjore kur ka lëshuar licencën, konkretisht nuk ka respektuar distancën prej 500 metrave.

E paditura më tutje në përgjigjen në padi pohon se nga kërkesa e datës 03.02.2014 e banorëve të fshatit Dobërdolan kanë kërkuar nga komuna e Suharekës që të shfuqizohet pëlqimi 01-Nr-16-4200 i datës 05.06.2013 i komunës pasi që ai nuk ka qenë në harmoni me aktet ligjore, me ç’rast komuna duke u bazuar nga matjet gjeodezike të ZK-Suharekë të gjeodetit M. K. i datë 10.09.2013 vlerëson se KPMM-ja ka lëshuar licensën e saj në kundërshtim me pëlqimin e cituar si dhe me Ligjin. E paditura poashtu pohon se e paditura e ka tërhequr pëlqimin konform kompetencave të saja pas shprehjes së pakënaqësive nga banorët e fshatit Dobërdolan. Shton se nga matjet gjeodezike të kompanisë N.P. G. e datës 27.07.2013 është tërësisht e pamundur të kuptohet se cila ka qenë pika referuese e matjes e paraqitur si objekt, për të cilën tani i propozojmë Gjykatës që të caktoj një ekspert gjeodet të pavarur i cili duhet të bëj matjet gjeodezike në teren pasi që siç shihet këto dy ekspertiza nuk korrespondojnë mes vete. Sa i përket pretendimit të paditësit për dëm material e kundërshton si të pabazuar ndërsa e njofton Gjykatën se në Departamentin për Çështje Ekonomike është duke u zhvilluar një procedurë tjetër për kompenzimin e dëmit, por e njëjta është ndërprerë derisa të zgjidhet kjo çështje gjyqësore.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i të paditurës deklaroi: *“Mbes në tërësi si në përgjigje në padi dhe deklarimet në seancën e kaluar. Kam pranuar dy ekspertizat atë financiare dhe gjeodezisë dhe për të dyja kam vërejtje dhe pyetje”.* Fillimisht do të filloj me ekspertin e gjeodezisë.

Përfaqësuesi juridik i të paditurës pyet ekspertin e gjeodezisë Valmir Krasniqi se: *“A e keni kuptuar detyrën e cila ju është dhënë nga gjykata?”.*

Eksperti i gjeodezisë V. K. përgjigjet: *“Pas leximit të të gjitha dokumenteve të ofruara kam kuptuar se detyra ime është me përcaktuar saktë distancën e cila është kontestuar në seancën e fundit”.*

Pyetje: *“A mund të na thuani se në cilën parcelë e keni bërë këtë matje pra cili është numri i kësaj parcele?”*

Përgjigje: *“Në bazë të leximit të shkresave unë e kam vërejtur një gabim teknik tek numri i parcelës të zonës për shfrytëzim dhe në bazë të koordinatave dhe matjeve që i kam bërë deklaroj me përgjegjësi të plotë se bëhet fjalë për parcelën 1965-0 e cila gjendet në pëlqimin e dhënë nga e paditura dhe e njëjta i referohet edhe licencës së dhënë nga KPMM e cila po ashtu i referohet pëlqimit të Komunës”.*

Pyetje: *“Sa është distanca në mes shtëpisë së ndërtuar në atë zonë dhe zonës së minimit?”*

Përgjigje: *“Në ekspertizë kam bashkëngjitur një ortofoto të vitit 2012, e në këtë foto duken dy objekte që i kam emërtuar me objekti A dhe B, Objekti A duket se është objekt i përfunduar ose në përfundim dhe objekti B që duket objekt në ndërtim e sipër pra fillim ndërtimi dhe në bazë të këtyre matjeve është bërë matja në dy objektet prej skajeve më të afërta të objekteve dhe prej qendrës së objektit A si kontroll e matjes së parë që është prezantuar me prova, matjet e bëra nga qendra e objektit A japin sipërfaqet: Sipërfaqja në zonën për shfrytëzim me distancë prej 500 m2 nga qendra e objektit A rezulton se është sipërfaqe prej 3060 m2, dhe sipërfaqja e cila është në distancë nën 500 m2, është 4123 m2, prej kësaj përfundoj se nga qendra e objektit A deri te pika 1 e zonës për shfrytëzim është distancë 462 m2, prej pikës 2 të zonës për shfrytëzim e deri te e qendra e objektit A është distancë 463 m2, dhe prej pikës 3 deri te qendra e objektit A është distancë 464 m2.*

Matja tjetër e bërë nga skaji i objektit A pika O2 pas tërheqjes së rrezes prej 500m2 në zonën e shfrytëzimit kemi fituar sipërfaqen prej 2309m2, e cila është në distancë prej 500m2, nga skaji i objektit A, dhe sipërfaqja 4874m2, e cila është në distancë nën 500m2, nga skaji i objektit A pika O2”.

Përfaqësuesi juridik i të paditurës pyet ekspertin financiar: *“A mund të na ofroni dëshmi se këto asete qëndrojnë në këtë hapësirë dhe si e keni llogaritur zhvlerësimin e aseteve?”.*

Ekspertja financiare përgjigjet: *“Në dosjen e pranuar në të ka qenë lista e aseteve që i ka poseduar kompania në atë periudhë sipas raportit të auditorit të licencuar , në të kanë qenë të figuruar vlerat neto të aseteve për periudhën 2014. Është politikë e kompanisë ku në raport të auditorit është cekur se të gjitha mjetet zhvlerësohen me normën 20 %, ku sipas standardit ndërkombëtar të kontabilitetit i përkasin kategorisë II të zhvlerësimit . Duke u bazuar në vlerën neto është përdorur metoda e Saldos Zbritëse sipas standardit të SNK-së, për zhvlerësimin aseteve të Kompanisë”.*

Pyetje: *“A keni njohuri se në këtë kohë kur është bërë raporti i auditimit për kompaninë, kompania në fjalë ka dhe gurthyes tjetër të cilën vazhdon ta shfrytëzoi pra në zonën kadastrale Biraq rr.”Tek Solidi”, po ashtu Betonjerkën dhe pllakat për prerje të kubzave dhe makinerinë për prodhim të blloqeve i ka të vendosura në Zonën Industriale parcelën”.*

Përgjigje: *“Në bazë të dokumentacionit të lëndës të gjitha të dhënat janë marr nga raporti i auditorit raport ky ku ceket se auditimi është bërë për periudhën kontestuese dhe i referohet çështjeve të ngritura në këtë konflikt administrativ”.*

Përfaqësuesi juridik i të paditurës nuk kishte pyetje tjera për ekspertët.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Mbesim në tërësi si në përgjigje në padi po ashtu shtoj se gjykata pas administrimit të provave të nxjerr aktgjykim ku refuzon padinë dhe kërkesën e palës paditëse për arsye se duke u mbështetur edhe në ekspertizën e ekspertit gjeodet shihet qartë se distanca nga zona e minimit e deri tek shtëpia është më pak se 500m, e po ashtu vlen të ceket se në pasusin e parafundit të pëlqimit të dhënë nga K.K. Suharekë, thuhet në rast të mosrespektimit të kufizimeve që dalin nga ligjet e aplikueshme në Republikës e Kosovës, Komuna e Suharekës ruan të drejtën e tërheqjes së këtij pëlqimi , andaj bazuar në këtë Komuna ka marr vendim për tërheqje të këtij pëlqimi sepse nuk janë respektuar ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës që ka të bëjë me distancën e largësisë. Po ashtu paditësi në këtë çështje të konfliktit administrativ ka paraqitur licencën e tij dhe shihet qartë se kjo licencë është dhënë për parcelën e 1956 dhe fare nuk ka të bëjë me parcelën që i është dhënë pëlqimi nga ana e të paditurës. Po ashtu kërkoj nga gjykata dhe njoftoj se për çështje financiare siq kam njoftuar edhe në përgjigje në padi është duke u zhvilluar edhe një procedurë tjetër në Departamentin Ekonomike, andaj kërkoj nga gjykata që aktgjykimin të nxjerrë si në propozimi e lartcekur”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, pas pranimit të ekspertizës financiare përfaqësuesi i paditësit precizoi kërkesëpadinë ashtu që kërkoj nga gjykata të aprovoj padinë dhe kërkesën e saj dhe të konstatohet se dëmi i shkaktuar nga akti administrativ i të paditurës është në shumë prej 3,524,373.15€ ashtu siç është llogaritur nga ekspertja financiare. Gjykatës dhe palës së paditur i dorëzoi deklaratën noteriale të datës 03.07.2013 të personave të cilët kanë parcela përreth. Në lidhje me këtë, gjykata me aktvendim procedural, lejoi precizimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të paditësit.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri vlerësimin dhe administrimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku dhe atë: licenca për shfrytëzim me numër 1308/KPMM/2013 dt. 03.09.2013, njoftimi – përgjigjja nga KPMM e dt. 21.11.2013, vendimi i të paditurës me numër 01-nr-16-902 i dt. 11.02.2014, aktgjykimi i kësaj gjykate nën shenjën Anr.316/14 dt. 11.12.2017, aktgjykimi Gjykatës së Apelit nën shenjën AA.nr.84/2018 dt. 07.11.2018, vendimi i kontestuar i marr nga e paditura me numër 01-nr-01-016-10043 i dt. 06.02.2019, licenca e dt. 02.09.2013, raporti i auditorit të pavarur i muajit shkurt 2015, pëlqimi për vazhdimin e procedurës së licencimit në organet kompetente i dt. 04.06.2013, ekspertiza financiare dt. 09.06.2022, ekspertiza e gjeodezisë e dt. 20.06.2022 dhe procesverbali i kësaj Gjykate i datës 22.06.2022.

Në pyetjen e gjykatës nëse palët kanë vërejtje në leximin e provave apo propozime për plotësimin e tyre, pala paditëse u deklarua pa propozime për prova të reja dhe pa vërejtje për provat e administruara ndërkaq pala e paditur me vërejtje për provën e deklaratës noteriale, ndërkaq pa vërejtje për provat tjera të lexuara.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata gjeti se paditësi ishte pajisur me Licensë valide të lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale si dhe kishte pasur pëlqimin e lëshuar nga e paditura për të kryer aktivitetet e shfrytëzimit të gurit gëlqeror.

Gjykata poashtu gjeti se pas kërkesës nga disa banorë të vendit ku po kryente aktivitetin e tij paditësi, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, kishte refuzuar kërkesën e tillë duke pohuar me plotë të drejtë që licenca për paditësin ishte dhënë në përputhje të plotë me Ligjin dhe se distanca prej 500 metrash ishte respektuar nga ana e paditësit dhe kjo ishte lehtë e vërtetueshme edhe me skicat dhe matjet të cilat ishin bërë e të cilat i ishin bashkëngjitur licensës. Megjithatë, gjykata gjeti se e paditura me vendimin 01-Nr-16-902 të datës 11.02.2014 kishte shfuqizuar Pëlqimin e dhënë me numër 01-Nr-16-4200 të datës 05.06.2013.

Gjykata gjeti se ndaj këtij vendimi, paditësi kishte hapur konflikt administrativ në këtë Gjykatë, e cila me Aktgjykimin A.nr.316/14 të datës 11.12.2017, pasi kishte konstatuar mangësi dhe shkelje të shumta, e kishte anuluar këtë vendim të të paditurës dhe çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Ndaj këtij Aktgjykimi, e paditura kishte ushtruar ankesë e cila ishte refuzuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin AA.nr.84/2018 të datës 07.11.2018. Ndonëse të gjitha pretendimet ankimore i ishin refuzuar nga të dy shkallët e Gjykatave, e paditura, me vendimin e kontestuar në këtë konflikt administrativ, pra vendimin 01-Nr-016-10043 të datës 06.2.2019, kishte marrë vendim të njëjtë duke mos marrë aspak parasysh pikëpamjet juridike të gjykatës si dhe vërejtjet e dhëna për të paditurën. Paditësi, brenda afatit ligjor kishte parashtruar padi të re në këtë Gjykatë me të cilën me të drejtë kishte kërkuar anulimin e këtij akti administrativ të të paditurës.

Gjykata, mbi bazë të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, duke vlerësuar ligjshmërinë e nxjerrjes së aktit përfundimtar përkatësisht vendimit 01-Nr.01-016-10043 të datës 06.02.2019, evidentoi shkelje thelbësore të dispozitave procedurale administrative, ligjit material e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe jo të drejtë nga e paditura.

Në kontekst të vlerësimit të ligjshmërisë së nxjerrjes së këtij akti administrativ, gjykata fillimisht vlerësoi aspektin formal të aktit administrativ përfundimtar i cili ishte objekt shqyrtimi e vlerësimi në këtë konflikt administrativ. Në këtë kuptim, gjykata gjeti se e paditura, në pjesën hyrëse të vendimit të kundërshtuar me këtë padi, i referohet, ashtu siç paraqitet në vendim: “*nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës Administrative*”. Një referencë e tillë në mënyrë të menjëhershme krijon konfuzitet dhe paqartësi për të gjitha palët e përfshira në procedurën administrative, e veçanërisht për paditësin, për faktin që nëse i referohemi “*nenit 44*” të Ligjit tashmë të shfuqizuar për Procedurën Administrative, i njëjti rregullon vërtetimin e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ. Në anën tjetër, nëse i referohemi numrit të Ligjit në të cilin është mbështetur e paditura, pra numrit “*05/L-031*”, ky Ligj me nenin 44 të tij, sa i përket procedurës së përgjithshme administrative, e trajton çështjen e përkufizimit të aktit administrativ. Në këtë drejtim, edhe nëse mund të mirret secila nga këto dy

mundësi si referencë e të paditurës për ta bazuar vendimin e saj, gjykata konstatoi se të njëjtat janë në kundërshtim me frymën e nenit 47, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet qartë si në vijim: “*1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes*”. Kështu, gjykata gjeti se e paditura ka shkelur nenin 47, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pikërisht me mos përcaktimin e saktë të bazës ligjore. Gjkata poashtu gjeti se shkelja e nenit 47, paragrafi 1, nën-paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nga e paditura, është manifestuar edhe me faktin se në pjesën hyrëse të vendimit të kontestuar, e paditura nuk ka përcaktuar as emrin e atij të cilit i drejtohet akti-në këtë rast paditësit, ashtu siç nuk ka përcaktuar as një shënim të shkurtër të lëndës së procedurës, për çka ka qenë e obliguar pikërisht nga neni 47, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kundërligjshmëria e vendimit të atakuar të të paditurës manifestohet edhe në atë se dispozitivi është tërësisht i paqartë dhe kontradiktor me arsyetimin e këtij vendimi. Në pjesën e dispozitivit të këtij vendimi, organi i paditur, pas vendimit mbi shfuqizimin e pëlqimit të dhënë për paditësin, ndër të tjera më tutje konstaton: “*pasi që nuk janë përfillur kushtet e veçanta të përcaktuara në pëlqim nga organi kompetent Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë*”. Nisur nga një konstatim i tillë, organi i paditur nuk e bën të qartë se kush ka shkelur kushtet e veçanta: Komisioni i Pavarur për Miniera Minerale apo paditësi në cilësinë e personit juridik. Për më tepër, gjykata gjeti se organi i paditur nuk ka arritur që qartë të përcaktoj nëse kemi të bëjmë me shfuqizim të plotë apo të pjesshëm të pëlqimit të dhënë për paditësin. Cilësimi i tillë është i obligueshëm për të paditurën mbi bazën e nenit 53, paragrafit 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Gjkata poashtu konstatoi se e paditura ka dështuar të paraqes informacionet e nevojshme në lidhje me shpenzimet e procedurës administrative dhe nëse ato janë të zbatueshme. Shpenzimet e procedurës do të duhej të veçoheshin në një pikë të veçantë të dispozitivit. Në lidhje me këto gjetje, gjykata ju referua nenit 47, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në të cilin përcaktohet: “*1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit*”.

Sa i përket pjesës arsyetuese, gjykata gjeti poashtu se arsyetimi i vendimit të kundërshtuar me këtë padi, është i hartuar në tërësinë e tij në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton: “*Neni 48 Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*”. Në kontekst të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me këtë padi, në pjesën e Arsyetimit, gjykata

konstatoi se e paditura ka dështuar të paraqes shkurtimisht kërkesën e palës, të shpjegoj nga aspekti faktik se si ka ardhur deri te vendimi i tillë duke i përfshirë radhitjen e shkaqeve që e kanë sjellë deri te një vendim i tillë, bazën e saktë ligjore dhe se cilat pretendime të ngritura nga pala paditëse nuk janë pranuar dhe arsytimi pse nuk janë pranuar ato.

Gjykata gjeti se e paditura, në pjesën fundore të arsytimit pohon se Kryetari i Komunës mori parasysh vërejtjet e gjykatës së shkallës së parë, të cilat i inkorporoi në këtë vendim. Megjithatë, e paditura, kishte dështuar të specifikoj saktësisht gjetjet e gjykatës dhe se në cilën pjesë të vendimit janë inkorporuar këto vërejtje. Në këtë drejtim, gjykata hodhi poshtë këto pretendime të të paditurës, për faktin që asnjëra nga vërejtjet e dhëna me Aktgjykimin paraprak të kësaj Gjykate nën shenjë A.nr.316/14 të datës 11.12.2017, nuk është inkorporuar e as zbatuar nga e paditura. Si rezultat i mospërfilljes së këtij Aktgjykimi nga ana e të paditurës, e njëjta ka dështuar të zbatoj të gjitha vërejtjet e Gjykatës e veçanërisht ato vërejtje të cilat i referohen veprimit të të paditurës në kundërshtim me nenin 9.2 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale si dhe vërejtjet që kishin të bëjnë me atë se si është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura. Duke mos vepruar sipas pikëpamjeve juridike dhe vërejtjeve të Gjykatës, e paditura kishte shkelur nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton si në vijim: *“Neni 65 Karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit- Kur gjykata e anulon aktin, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që, në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër, organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë pa shtyrje, jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit. Organi kompetent, në këtë rast, është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën”*.

Në kontekst të vlerësimit të arsytimit të vendimit të kundërshtuar në padi, përveç aspektit formal, gjykata vlerësoi se kundërligjshmëria e këtij vendimi, poashtu manifestohet edhe në konstatimet jo ligjore dhe të pabazuara në ligj të të paditurës e cila, ndër të tjera konstaton si në vijim: *“Bazuar nga thëniet e cekura më lartë është konstatuar se organi kompetent Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë, që ka të bëjë me dhënien e licensës për eksploatimin dhe shfrytëzimin e gurit me minim (eksploziv), nuk i ka respektuar kushtet e veçanta të përcaktuara në pëlqim”*. Në lidhje me këtë konstatim të të paditurës, gjykata erdhi në përfundim se nuk ishte dhe nuk mund të jetë në kompetencë të të paditurës si organ administrativ, të vij në përfundime, konkluzione e konstatime me të cilat vlerëson nëse licenca apo leja e caktuar e një organi poashtu administrativ-në këtë rast Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, është lëshuar apo jo duke respektuar kushte të caktuara. Në këtë kuptim, gjykata vë në pah rëndësinë e sqarimit se i vetmi autoritet i cili mund të vlerësoj ligjshmërinë e nxjerrjes së një akti administrativ, duke përfshirë por duke mos u kufizuar edhe në vlerësimin e lëshimit të lejes apo licensës nga një autoritet kompetent, është kjo Gjykatë e cila ka kompetencë ekskluzive lëndore dhe territoriale, e në asnjë rast organi i paditur nuk mund të vlerësoj e as konstatoj asgjë në lidhje me ligjshmërinë apo kundërligjshmërinë e nxjerrjes së akteve administrative nga një organ tjetër i administratës shtetërore në Republikën e Kosovës.

Në kontekst të vlerësimit të ligjshmërisë së këtij akti në pjesën e fundit të tij pra të Këshillës Juridike, gjykata ju referua nenit 47, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton si në vijim: *“1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.4. pjesën*

përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se e paditura gjithashtu ka shkelur nenin 47, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke mos treguar kohën e hyrjes në fuqi të këtij akti në këtë pjesë të vendimit dhe duke mos e përcaktuar në mënyrë të saktë llogaritjen e afatit përkatës. Në këtë drejtim, e paditura llogarit afatin për paraqitjen e padisë në Gjykatë nga dita e dërgimit të këtij vendimi me shkrim, e jo nga dita e pranimit, përkatësisht dorëzimit të këtij akti palës, ashtu siç kërkohet dhe përcaktohet me nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative në të cilin përcaktohet si në vijim: “Neni 27 1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës”. Pra kjo dispozitë ligjore cila i referohet datës së dorëzimit të aktit palës, e jo datën e dërgimit të aktit nga ana e organit të administratës.

Gjykata poashtu nga provat e administruara dhe deklaratimet e palës së paditur në shqyrtimin kryesor, nuk gjeti asnjë fakt, provë apo dëshmi që e paditura të ketë njoftuar palën paditëse për të drejtën e saj për t’u dëgjuar. E drejta e palës për t’u dëgjuar paraqet një nga Institutet më të rëndësishme në procedurën administrative e cila i garanton palës pjesëmarrëse trajtim të barabartë, transparencë dhe barazi në lidhje me administrimin e procedurës administrative. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se ka qenë obligim i të paditurës që palën paditëse ta njoftoj për tu dëgjuar dhe të njëjtën edhe ta dëgjoj para marrjes së vendimit përfundimtar. Me mos-respektimin e kësaj të drejte, e paditura ka shkelur nenin 95 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton obligimet e organit të administratës, përkatësisht të të paditurës në këtë rast: “Neni 95 E drejta e dëgjimit

- 1. Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t’u dëgjuar.*
- 2. Njoftimi, i paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, do të përshijë informacionin mbi rezultatet e shqyrtimit administrativ, rezultatit e mundshëm të procedurës si dhe informacionin mbi mënyrën e ushtrimit të së drejtës së dëgjimit.*
- 3. E drejta për t’u dëgjuar mund të ushtrohet me shkrim apo gojarisht dhe regjistrohet në procesverbal nga organi publik.*
- 4. Kur dëgjimi ndaras i secilës prej palëve të përfshira, në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, është jopraktik për shkak të numrit të madh të palëve, dëgjimi do të zhvillohet në çfarëdo mënyre të përshtatshme të dëgjimit të përbashkët”.*

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i vendimit të kontestuar me këtë padi, gjykata konstatoi poashtu se e paditura kishte injoruar në tërësi Vendimin me Nr.protokoli 4520 të datës 21.11.2013 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i cili në takimin e datës 31.10.2013 të Bordit, pas trajtimit të ankesës, përkatësisht kërkesës nr.6264 të datës 12.09.2013, kishte marrë vendim që: “Kërkesa e banorëve të fshatit Dobërdolan, K.K. Suharekë të refuzohet sepse Licensa me nr.1308/KPMM/2013, është në përputhje me nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale”. Ky veprim dhe sjellje e të paditurës, për të mos marrë fare në konsideratë e as shqyrtim këtë vendim të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, është shkelje e nenit 7 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili në mënyrë të qartë përcakton si në vijim: “Neni 7 Parimi i objektivitetit dhe

paanësisë 1. Organi publik duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme. 2. Veprimet e zyrtarit publik nuk duhet të ndikohen nga ndonjë interes personal, familjar, miqësor, politik apo nga presioni politik”.

Gjykata poashtu erdhi në përfundim se me vendimin i cili ishte objekt shqyrtimi në këtë konflikt administrativ, nuk ishte vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe se nga faktet e vërtetuara në mënyrë jo të drejtë, kishte ardhur deri te konkluzioni jo i drejtë i gjendjes faktike.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, e duke marrë parasysh faktin që gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë konflikt administrativ, u identifikuan dy prova të kundërta në pikëpamje të asaj se sa ishte distanca në mes të zonës së minimimit dhe shtëpisë së banimit, gjykata aprovoi propozimin e përfaqësuesit të paditësit që të nxirret prova me ekspertizë gjeodezike në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë të matjeve nga terreni. Gjykata poashtu aprovoi propozimin e përfaqësuesit të paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, ku u përcaktua vlera e saktë e dëmit material në formën e fitim të humbur që kishte pësuar paditësi si pasojë e aktit administrativ të kundërshtuar si dhe kamatëvonesës, e cila do të përfshinte periudhën kohore nga data 11.02.2014 e deri më datë 30.08.2020. Në lidhje me këtë, gjykata me Aktvendim të veçantë nën shenjë A.nr.432/19 të datës 31.05.2022 e caktoi ekspertizën financiare të hartuar nga E. A. si dhe me Aktvendimin e veçantë A.nr.432/19 të datës 01.06.2022 kishte caktuar ekspertizën gjeodezike të hartuar nga eksperti V. K.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, konform nenit 431 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i aplikuar sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata i dha mundësinë të dy palëve ndërgjyqëse që të parashtrojnë të gjitha pyetjet e nevojshme për dy ekspertët e pranishëm në seancë.

Gjykata pasi pranoi ekspertizën gjeodezike të datës 08.06.2022 dhe pasi që dëgjoi ekspertin e pranishëm në seancën e shqyrtimit kryesor, për të njëjtën konstatoi se është e hartuar në mënyrë profesionale dhe i përmban të gjitha elementet konform nenit 364 të Ligjit për Procedurën Kontestimore i aplikuar sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, e rrjedhimisht gjykata i falë besimin e plotë kësaj ekspertize. Në këtë drejtim, gjykata njohu faktin që përfaqësuesi i paditësit nuk kishte asnjë vërejtje në lidhje me këtë ekspertizë, si dhe mori parasysh faktin që përfaqësuesi i të paditurës, ndonëse deklaroi se kishte vërejtje për këtë ekspertizë, i njëjti gjatë tërë rrjedhës së procesit gjyqësor, parashtroi vetëm pyetje për ekspertin nga lëmia e gjeodezisë por nuk pohoi asnjë vërejtje specifike dhe nuk dha ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re e cila potencialisht do të mund të sfidonte ekspertizën e hartuar nga eksperti i gjeodezisë. Në anën tjetër, gjykata poashtu mori në konsideratë edhe deklaratat e të paditurës të paraqitura në ankesën kundër Aktgjykimit A.nr.316/2014 të datës 11.12.2017, ku ndër të tjera, në faqen 3 të arsytimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nën shenjë AA.nr.84/2018 të datës 07.11.2018, citohen pretendimet e të paditurës, ku ndër të tjera, duke ju referuar kërkesës së vet të paditurës për matjet gjeodezike nga eksperti gjeodet, thotë: “...dhe nëse konstatohet se distanca do të jetë mbi 500m, atëherë këtu e paditura mund të jetë palë e cila i ka shkaktuar dëm paditësit”, e që në rastin konkret është vërtetuar me prova të pakontestueshme distanca mbi 500m siç do të elaborohet në vijim.

Nga vlerësimi dhe shqyrtimi i ekspertizës gjeodezike, gjykata gjeti se eksperti në mënyrë të qartë dhe profesionale ka paraqitur matjet me koordinata nga 18 pika. Gjykata poashtu e njohu faktin që matjet

gjeodezike ishin bërë për parcelën me numër 1965-0 dhe jo parcelën me numër 1956-0, dhe poashtu njohu konfirmimin nga ana e ekspertit se bëhet fjalë për një gabim teknik kur ishte kërkuar matja e parcelës 1956-0 duke pohuar me përgjegjësi të plotë se bëhet fjalë për parcelën 1965-0 e cila gjendet në pëlqimin e dhënë nga e paditura dhe i njëjta i referohet edhe licensës së dhënë nga KPMM e cila poashtu i referohet pëlqimit të Komunës. Në këtë drejtim, gjykata konfirmoi se vet e paditura i kishte dhënë Pëlqimin paditësit pikërisht për parcelën kadastrale 1965-0 dhe se matjet e realizuara nga gjeodeti ishin bërë pikërisht duke ju referuar kësaj parcele kadastrale. Gjykata gjeti se eksperti nga lëmia e gjeodezisë kishte bërë matjet e nevojshme ku kishte bashkëngjitur një ortofoto të vitit 2012, e në të cilën dukeshin dy objekte të cilat i kishte emërtuar me objekti A dhe B ku Objekti A duket se ishte objekt i përfunduar ose në përfundim dhe objekti B që duket objekt në ndërtim e sipër pra fillim ndërtimi dhe në bazë të këtyre matjeve është bërë matja në dy objektet prej skajeve më të afërta të objekteve dhe prej qendrës së objektit A si kontroll e matjes së parë që është prezantuar me prova, matjet e bëra nga qendra e objekti A japin sipërfaqet: Sipërfaqja në zonën për shfrytëzim me distancë prej 500 m2 nga qendra e objektit A rezulton se është sipërfaqe prej 3060 m2, dhe sipërfaqja e cila është në distancë nën 500 m2, është 4123 m2. Prej kësaj, eksperti i gjeodezisë kishte përfunduar se nga qendra e objektit A deri te pika 1 e zonës për shfrytëzim është distancë 462 m2, prej pikës 2 të zonës për shfrytëzim e deri te e qendra e objektit A është distancë 463 m2, dhe prej pikës 3 deri te qendra e objektit A është distancë 464 m2. Matja tjetër e bërë nga skaji i objektit A pika O2 pas tërheqjes së rrezes prej 500m2 në zonën e shfrytëzimit kemi fituar sipërfaqen prej 2309m2, e cila është në distancë prej 500m2, nga skaji i objektit A, dhe sipërfaqja 4874m2, e cila është në distancë nën 500m2, nga skaji i objektit A pika O2.

Në kontekst të vërtetimit të gjendjes faktike, Gjykata pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjitha matjet e bëra nga eksperti i gjeodizë, konstatoi se, ndër të gjitha matjet e bëra, pasqyrimi real i gjendjes faktike dhe baza reale faktike për kompenzimin e dëmit material për paditësin, konsiston pikërisht në matjet nga sipërfaqja për shfrytëzim e deri tek qendra e objektit “A”, në të cilën 6 nga 18 pikat matëse, rezultojnë të jenë nën 500 metra, respektivisht, distanca nga qendra e objektit A e deri tek pika 1 e zonës për shfrytëzim është distanca 462m, distanca nga qendra e objektit A e deri tek pika 2 e zonës për shfrytëzim është distanca 463m, distanca nga qendra e objektit A e deri tek pika 3 e zonës për shfrytëzim është distanca 464m, ku sipërfaqja totale e hapësirës e cila është nën 500m, rezulton të jetë 4123m2 [katërmijë e njëqind e njëzetë e tre metër katror]. Në anën tjetër, gjykata, gjithnjë duke u bazuar në ekspertizën gjeodezike, gjeti se 12 pikat tjera matëse reflektojnë distancën mbi 500 m2, të matur poashtu nga qendra e objektit “A”, përkatësisht pikat 7 deri në 18, ku sipërfaqja totale e hapësirës e cila është mbi 500m, rezulton të jetë 3060 m2 [tremijë e gjashtëdhjetë metër kator].

Në lidhje me kërkesën e paditësit për kompenzimin e dëmit material/fitimin e humbur, gjykata fillimisht ju referua nenit 17 të LKA-së në të cilin përcaktohet se: *“Neni 17 Në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra, si dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit me ekzekutimin e aktit që kontestohet”*.

Për të përcaktuar vlerën e saktë të dëmit material në formën e fitim të humbur që kishte pësuar paditësi si pasojë e aktit administrativ të kundërshtuar si dhe kamatëvonesës, e cila do të përfshinte periudhën kohore nga data 11.02.2014 e deri më datë 30.08.2020, gjykata mori në konsideratë dhe i fali besimin e plotë ekspertizës financiare. Në këtë drejtim, gjykata konstatoi se kjo ekspertizë financiare është

hartuar në mënyrë profesionale, sipas standardeve ndërkombëtare dhe në tërësi konform nenit 364 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm konform nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Në këtë drejtim, gjykata poashtu njohu faktin që përfaqësuesi i paditësit nuk kishte asnjë vërejtje në lidhje me këtë ekspertizë, si dhe mori parasysh faktin që përfaqësuesi i të paditurës, ndonëse deklaroi se kishte vërejtje për këtë ekspertizë, i njëjti gjatë tërë rrjedhës së procesit gjyqësor, parashtrori vetëm pyetje për ekspertin nga lëmia financiare, por nuk pohoi asnjë vërejtje specifike dhe nuk dha ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re e cila potencialisht do të mund të sfidonte ekspertizën e hartuar nga ekspertja financiare.

Gjykata gjeti se vlera totale për dëmin e shkaktuar e përlllogaritur nga ekspertja financiare, ishte në shumën prej 3,524,373.15€ [tre milion e pesëqind e njëzetë e katërmijë e treqind e shtatëdhjetë e tre euro e pesëmbëdhjetë cent], e llogaritur për tërë sipërfaqen e zonës për shfrytëzim, pra për 7183m². Mbi bazën e përlllogaritjes e duke u bazuar në skicën 1.4, faqe 6 të ekspertizës gjeodezike, gjykata aprovoi kompenzimin e dëmit për pjesën e sipërfaqes e cila tejkalon distancën prej 500m nga qendra e objektit A dhe e cila përfshinë sipërfaqen prej 3060m² [tre mijë e gjashtëdhjetë metër katror] apo e shprehur në përqindje paraqet 42.60% në raport me sipërfaqen totale, ndërkaq e shprehur në vlerë monetare, paraqet shumën prej 1,501,403.57€ [një milion e pesëqind e një mijë e katërqind e tre euro e pesëdhjetë e shtatë cent] e cila duhet ti paguhet paditësit. Ndërkaq njohja e kompenzimit të dëmit material për pjesën tjetër të mbetur në sipërfaqe prej 4123m², apo e shprehur në përqindje prej 57.40% në raport me sipërfaqen totale dhe në vlerë momentare prej 2,022,969.58€ [dy milion e njëzetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë e tetë cent], u refuzua si e pabazuar për faktin që kjo sipërfaqe rezulton të jetë nën distancën e lejuar me ligj prej 500 metrash.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet tjera të palës së paditur por të njëjtat i refuzoi si pa ndikim në vendosje ndryshe në këtë konflikt administrativ.

Në bazë të asaj që u tha më lartë, e në kuptim të nenit 17, 43, 46, paragrafit 2 dhe 5, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, lidhur me nenin 147 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.432/19, datë: 27.06.2022

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Numri i lëndës: 2019:277729
Datë: 27.06.2022
Numri i dokumentit: 03174652

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.